




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, dhe 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale nenit 14 paragrafi 8 e nënparagrafi 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.01.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

(Për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor për shkollat e komunës së Skenderajt)

Neni 1

Miratohet propozimi-vendim më Nr.07-020/01-0001755/26, i datës 12.01.2026, Për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor për shkollat e komunës së Skenderajt.

Neni 2

Drejtoria Komunale e Arsimit Skenderaj propozon këta anëtar të komisionit si në vijim:

- DKA - **Shkëndije Idrizi**,
- Përfaqësues këshillit të prindërve në nivel komunal me ekspertizë në fushën e arsimit - **Avdi Jakupi**.
- Përfaqësuesi nga MASHTI.

Neni 3

Detyrat e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtor për shkollat e Komunës së Skenderajt janë: të shikojë dokumentacionin e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar, të intervistojë dhe vlerësojë me pikë kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas procedurave të përcaktuara në nenin 14 paragrafi 8 e nënparagrafi 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullores (QRK) Nr.19/2024. Mandati i anëtarëve të komisionit është i përcaktuar sipas Rregullores (QRK) Nr.19/2024.

Neni 4

Zbatimin do ta bëjë: Drejtoria Komunale e Arsimit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe publikimit të tij në ueb – faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 DKA-së, (anëtarëve të komisionit),
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVNDIT

znj. Adelina Spahiu- Alija





REPUBLICA E KOSOVES
DALJE 10.02.26
8-580
6

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General
Secretary

REFERENC-Ë:	8-580
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Skenderajt Jeton Qelaj, sekretar i përgjithshëm ne MAPL Erblin Hetemi, u.d. udhëheqës i departamentit ligjor dhe monitorim të komunave MAPL
CC:	Fadile Dyla, sekretare e përgjithshëm/MASHTI
PËRMES/PREKO/THROUG:	Elhame Shabani, u.d. drejtore e departamentit Ligjor/ MASHTI
NGA/OD/FROM:	Hidajete Vokshi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, të mbështetjes ligjore dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e legjislacionit, Departamenti Ligjor – MASHTI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt me nr. 020-101/2 dt. 09.02.2026

Të nderuar,

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt vendimin me nr.Nr.01-020/01-0005093/26 i miratuar me datë 30.01.2026 për formimin e Komisionit për për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve për institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Skenderajt.

Në bazë të rregullores (QRK) nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe Emërimit të drejtorëve dhe Zv. Drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucione publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, vendimin Nr.01-020/01-0005093/26 i miratuar me datë 30.01.2026, është në përputhje me rregulloren.

Me respekt!